



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 412/8 prot.

Tiranë, më 30.9.2021

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 410, datë 30.6.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Atalanta Zeqiraj
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 17.9.2021 është njoftuar vendimi nr. 410, datë 30.6.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit znj. Atalanta Zeqiraj, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 17.9.2021, është depozituar akti “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 17.9.2021, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 410, datë 30.6.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, ushtron detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si *KLGG*), nga të cilat rezultojnë se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Atalanta Zeqiraj*”² ka referuar se:

- i. Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës³, ka referuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Atalanta *** Zeqiraj*”.

2.3 **KLGG**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin⁴ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Atalanta Zeqiraj.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Bazuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit, personin e lidhur dhe të tjerë të lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë **.1.2018.

³ Shkresa e DSIK-së nr. *** prot., datë **.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë **.5.2021.

⁴ Raport i KLGG-së nr. *** prot., datë **.9.2020.

administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ndër të tjera, ka arritur në përfundimin se: [...] referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës, kreut IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludon se subjekti i rivlerësimit, Atalanta Zeqiraj, ka kryer deklarin të mjaftueshëm dhe në vlerësim tërësor të saktë të pasurisë, duke konstatuar pasaktësi të karakterit minimal. Nga analiza e bërë nga Komisioni u konstatuan disa problematika, të cilat vijnë si rezultat i veprimeve të kryera nga babai i subjektit, si dhe mosveprimi në kohë i subjektit për të shmangur konfliktin e interesit në dukje. Por këto veprime dhe mosveprime të subjektit nuk mund të çojnë në konkluzionin se ndodhemi përpara një deklarimi të pamjaftueshëm dhe, për rrjedhojë, në aplikimin e masës disiplinore referuar nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, subjekti ka kryer deklarin të saktë të pasurive dhe interesave private, si edhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj në pronësi dhe përdorim. Subjekti nuk është përpjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi apo përdorim. Në rastin e subjektit të rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit justifikon plotësisht me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe në cash), si dhe kryerjen shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si gjyqtar [...] ⁵.

3.2 Për kontrollin e figurës. Bazuar në nenin DH të aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit nga institucionet përgjegjëse dhe pas hetimit administrativ të kryer prej tij, ka arritur në përfundimin se: [...] nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta [...] ⁶.

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Bazuar në nenin E të aneksit të Kushtetutës, nenin 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar dhe vlerësuar raportin e përgatitur nga KLGJ-ja, denoncimet nga publiku, provat dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues, në kuptim të gërmës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...] ⁷.

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, me vendimin nr. 410, datë 30.6.2021, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe

⁵ Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 39, të vendimit.

⁶ Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 39, të vendimit.

⁷ Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 39, të vendimit.

nenit 59, pika 1, ka vendosur: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.*

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”⁸ e aneksit të Kushtetutës, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 17.9.2021, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 410, datë 30.6.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Atalanta Zeqiraj (bashkëlidhur këtij ankimi).

5.1 Në mënyrë të përmbledhur, tre vëzhguesit ndërkombëtarë, nëpërmjet rekomandimit për paraqitje ankimi, e konsiderojnë të nevojshme që Kolegji i Posaçëm i Apelimit të vlerësojë nëse standardet dhe arsyetimi i përdorur nga Komisioni për zbatimin e parimit të proporcionalitetit në këtë rast janë në përputhje me standardet dhe arsyetimet e përdorura nga Kolegji për parimin e proporcionalitetit dhe zbatimin të tij në raste të krahasueshme, e në këtë mënyrë, sipas nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji, në arsyetimin e vendimit të tij, mund të orientojë Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

6. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

7. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

8. Në krahasim me kompetencat e njohura për Komisionin dhe Kolegjin, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

10. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, pasi shqyrtoi dhe vlerësoi vendimin nr. 410/2021 dhe aktet shoqëruese të tij, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, çmon se vendimi përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Lidhur me rrethanat ligjore e të faktit, sikurse do të trajtohen edhe në vijim, Komisioneri Publik i referohet edhe jurisprudencës së

⁸ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si organi i vetëm gjyqësor që vendos për vlerësimin përfundimtar në këtë proces.

11. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës si dhe nenet 4, 59/1 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 410/2021 të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

IV.A. Kontrolli i pasurisë

12. Si një ndër tri kriteret e procesit të rivlerësimit kalimtar, kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë e gjejmë të materializuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku realizimin e qëllimit të nenit 179/b, pika 1, të Kushtetutës, këto norma e konkretizojnë në identifikimin e subjekteve që: (i) kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose (ii) nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin kushtetues për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, ekzistencën e të ardhurave të ligjshme dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

13. Në vlerësim të akteve të administruara dhe përmbajtjes së vendimit të Komisionit, objekt ankimi, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Atalanta Zeqiraj, është bërë subjekt deklarues prej vitit 2013, duke plotësuar dhe dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie. Në vijim, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë plotësuar dhe dorëzuar deklarata periodike të interesave private, si dhe atë “Vetting” (datë 27.1.2017).

14. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, për kriterin e pasurisë kanë rezultuar problematika që, për nga rrethanat dhe situata faktike, janë të njëjta e të cilat lidhen me kontrollin e ligjshmërisë së burimit të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, të atit të subjektit të rivlerësimit, pasuritë në pronësi të të cilit (dy apartamente) janë përdorur apo vijnë të përdoren prej subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, bashkëjetuesi. Gjithashtu, nga hetimi administrativ ka rezultuar se personi tjetër i lidhur, i ati i subjektit të rivlerësimit, ka siguruar burimin e financimit për blerjen e një automjeti në pronësi të personit të lidhur, bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit, si dhe ka dhënë në formën e dhurimit mjete monetare në ndihmë të subjektit.

14.1 Komisioni ka konstatuar edhe situatën e konfliktit të interesit që ndodhej subjekti i rivlerësimit në ushtrimin e detyrës, ndërlidhur me aktivitetin privat të personit të lidhur, të atit të saj, në vështrim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar⁹.

⁹ Referuar ndryshimeve që ka pësuar ky ligj nga ligji nr. 44/2014, neni 21/1, përcakton se: “Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërën nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, **gjyqtarët** e prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik. Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues, të parashikuar në nenin 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut III, seksioni 2, të këtij ligji, ndalimi sipas paragrafit të parë të kësaj pike, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuar në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë”. Në vijim të këtij ligji, sipas nenit 24/1 të tij,

15. Problematikat e mësipërme janë vërejtur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe vlerësimit të interesave private të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëjetuesi, në referencë të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, për pasuritë e deklaruara si më poshtë vijon.

15.1 Apartament banimi në përdorim, Vlorë

15.1.1 Në *D.Vett.*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Banoj në apartamentin e blerë nga babai im, ***.***, me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme me rezervë, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.10.2015, i cili ndodhet në lagjen “****”, rruga “**** ****”, kompleksi “**** ****”, kulla **, kati i **. Apartamenti është i babait tim, për përdorimin e tij nuk paguajmë qira. Burimi i krijimit të pasurisë: nuk deklarohet. Vlera: 3.800.000 lekë. Pjesa takuese: 0%.*

15.1.2 Në *DV-2016*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar njësoj si më sipër.

15.2 Apartament banimi në përdorim, Tiranë

15.2.1 Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorëve, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, gjatë periudhës shtator 2014 - tetor 2015, ka përdorur pa kundërshtëpërbllim pasurinë *Apartament nr. **, rruga “**** ****”, h. **, ap. **, Tiranë*, në pronësi të babait të saj.

15.3 Automjet tip “Mercedes Benz”

15.3.1 Në *D.Vett.*, personi i lidhur, bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar: makinë “Mercedes Benz B Class”, me targë ***, blerë në vitin 2014, në vlerën 5.000 euro. Burimi i krijimit: të ardhurat për blerjen janë dhënë nga babai i deklaruësës, *** ***. Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.12.2014. Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., dt. **.3.2015.

15.3.2 Në *DV – 2014*, në faqen e deklarimit të të dhënave konfidenciale, personi i lidhur, bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar njësoj si më sipër.

15.4 Dhurime në favor të subjektit të rivlerësimit

15.4.1 Në *D.Vett.*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga babai i saj (transfertë nga babai ***.***), në shumën 200.000 lekë.

15.4.2 Në *DV-2014*, subjekti i rivlerësimit në faqen e deklarimit të të dhënave konfidenciale, ka deklaruar si dhurime nga i ati shumën 150.000 lekë.

15.5 Konflikti i interesit

15.5.1 Nga hetimi administrativ i Komisionit kanë rezultuar se: (i) Subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e trungut familjar deri në datën **.9.2016; (ii) Personi tjetër i lidhur, i ati i subjektit të rivlerësimit, është ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë “****” sh.p.k.; (iii) Gjatë periudhës 2014-2018, shoqëria “****” sh.p.k. ka marrë pjesë në procedura të prokurimit publik dhe ka përfituar fonde publike nga kontratat e lidhura me institucionet shtetërore.

përcaktohet edhe rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenet 21 dhe 22 të këtij ligji, përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.

16. Komisioni, pasi ka vlerësuar tërësinë e akteve të administruara, për secilin deklaram të interesave private si më sipër dhe për gjendjen e konfliktit të interesit të konstatuar, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës subjektivit të rivlerësimit, lidhur me çështjet në vijim:

16.1 Për pasurinë në përdorim, apartament me sip. 74 m², ndodhur në Vlorë:

- Subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur me të (i ati i subjektivit), duhet të provojnë burimin e ligjshëm për krijimin e pasurive në përputhje me pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016;
- Shpjegimet e dhëna dhe pasqyrat financiare të shoqërisë “****” sh.p.k., të sjella si prova nga subjekti i rivlerësimit nuk sqarojnë në mënyrë shteruese kërkesën e Komisionit. Vlerat e dhëna në bilanci vjetore janë vlera në fund të vitit, të cilat nuk sqarojnë veprimet e bëra gjatë vitit;
- Kërkohen shpjegime pse subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme në përdorim, në deklaratën “Vetting” dhe në DV- 2015.

16.1.1 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse dhe gjatë hetimit administrativ, duke deklaruar, ndër të tjera, se: *“Kjo pasuri është blerë nga babai im, ***. ***, i cili nuk është person tjetër i lidhur sipas pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Ai nuk ndodhet në kushtet e dhurimit apo huas... Burimi i krijimit të kësaj pasurie është huaja e marrë nga shoqëria “****”, ku babai është aksioner i vetëm dhe administrator i shoqërisë. Sipas statementeve bankare rezulton se nga llogaria e shoqërisë “****” janë kaluar fondet për blerjen e pasurisë apartament në llogarinë e babait, në datën **.10.2015”*¹⁰

16.1.2 Komisioni, për sa më sipër, ka vlerësuar se: [...] *duke arsyetuar mbi bazën e parimeve të objektivitetit të proporcionalitetit, në konsideratë të fakteve e provave të administruara, si periudhën e përdorimit të pasurisë nga subjekti; fillimin e detyrës së saj si gjyqtare; burimin e krijimit të pasurisë, vlerat dhe mundësitë financiare të shoqërisë “****” sh.p.k, faktin që çdo veprim është kryer nga babai i subjektivit si përfaqësues ligjor i shoqërisë dhe jo nga subjekti, mungesën e çdo lloj lidhjeje e indicieje për lidhje të subjektivit me pronësinë e kësaj pasurie, në raport edhe me shpjegimet e subjektivit, Komisioni çmon që subjekti nuk ndodhet në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat 1 dhe 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 [...]* ¹¹.

16.2 Për pasurinë në përdorim, apartament me sip. 45 m², ndodhur në Tiranë:

- Konstatohet se kjo pasuri është blerë nga babai i subjektivit më datë **.9.2014, pra në periudhën e kryerjes së stazhit nga ana e subjektivit si gjyqtare pranë Gjykatës së rrethit Tiranë;
- Kjo pasuri nuk është deklaruar si pasuri në përdorim pa kundërshtpërblim (gjatë periudhës 2014-2015);
- Personi tjetër i lidhur me subjektivin, nuk ka provuar legjitimitetin e të ardhurave nga biznesi për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2014, në shumën 50.000 euro;
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të drejtat reale mbi këtë pasuri në DV- 2014 – 2015.

¹⁰ Për kryerjen e veprimeve financiare të shoqërisë është hartuar edhe një raport nga audituesi ligjor z. ***. ***. Sipas audituesit, veprimet financiare për dhënie e huas janë regjistruar dhe kontabilizuar në librat kontabël të shoqërisë.

¹¹ Referohuni arsyetimit në f. 8-11, të vendimit të Komisionit.

16.2.1 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se: “... kjo pasuri është blerë nga babai im, ***, ***, në vitin 2014. Babai im nuk është person tjetër i lidhur sipas pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Ai nuk ndodhet në kushtet e dhurimit apo huas.. Kjo pasuri apartament nuk lidhet me detyrën time si gjyqtare dhe nuk ka të bëjë me ndonjë konflikt të mundshëm interesi, pasi në atë periudhë kam qenë duke kryer stazhin si gjyqtare. Kjo pasuri është deklaruar nga ana ime si adresë banimi në DPV-në e vitit 2014. Burimi i krijimit të kësaj pasurie është huaja e marrë nga shoqëria “***”, ku babai është aksioner i vetëm dhe administrator i shoqërisë. Sipas statementeve bankare rezulton se nga llogaria e shoqërisë “***” janë kaluar fondet për blerjen e pasurisë apartament në llogarinë e babait, në shumën prej 50.000 euro”.

16.2.2 Komisioni, për sa më sipër, ndër të tjera, ka vlerësuar se: [...] Bazuar në pikën 3, të nenit D të aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet se: “... pasuri të ligjshme për qëllime të ligjit konsiderohen të ardhurat e deklaruar për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Për qëllime të procesit të rivlerësimit si të ardhura të ligjshme duhen konsideruar vetëm të ardhurat, të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative dy kritere: (i) janë të deklaruar; (ii) për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi”. Dhënia e fondeve nga shoqëria “***” sh.p.k. për blerjen e pasurisë apartament në përdorim nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2014 dhe reflektimi i kësaj huaje në librat kontabël të shoqërisë dhe pastaj në pasqyrat financiare, nuk ka sjellë shmangie të detyrimeve tatimore, pavarësisht se veprimi i përfitimit të shumës prej 50.000 euro nuk është bërë duke shpërndarë fitimin (dividendin) në fund të vitit përkatës. Marrë në konsideratë faktet dhe rrethanat, si vijojnë: (i) përfitimin nga babai i subjektit dhe përdorimin e kësaj pasurie nga subjekti në vitin 2014, periudhë kur znj. Atalanta Zeqiraj kryente stazhin si gjyqtare, si dhe faktin që në DV-në për këtë vit subjekti e ka deklaruar adresën e kësaj pasurie si adresë vendbanimi; (ii) veprimet e kryera dhe të reflektuara nga shoqëria “***” sh.p.k. në librat përkatës në lidhje me huan që kjo shoqëri i ka dhënë ortakut të vetëm ***, ***,; (iii) kryerjen e të gjitha veprimeve në rrugë bankare si nga ana e shoqërisë “***” sh.p.k., si person juridik, ashtu edhe nga ana e administratorit të saj si individ; (iv) qarkullimin dhe mjetet e lira monetare në vlera të konsiderueshme të shoqërisë “***” sh.p.k., Komisioni krijoi bindjen se për këtë pasuri të blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit nuk ka problematika dhe dyshime, dhe nuk u evidentua asnjë lidhje e subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri. Veç kësaj, në analizë të çdo deklarami të subjektit, si dhe provave shkresore të administruara, nuk mund të arrihet në konkluzionin që babai i tij nuk pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë, e aq më tepër që këto të ardhura të kenë qenë të subjektit të rivlerësimit [...] ¹².

16.3 Për pasurinë automjet tip “Mercedes Benz”:

- Shpjegimet e dhëna dhe pasqyrat financiare të shoqërisë “***”, të sjella si prova nga subjekti, nuk sqarojnë në mënyrë shteruese kërkesën e Komisionit dhe burimin e ligjshëm të huas për blerjen e kësaj pasurie në vlerën prej 5.000 euro. Vlerat e dhëna në bilancet vjetore janë vlera në fund të vitit, të cilat nuk sqarojnë veprimet e bëra gjatë vitit. Subjekti duhej të kishte sjellë të dhëna/regjistrime më analitike për të vërtetuar veprimet e kryera nga shoqëria lidhur me pasqyrimin e veprimeve në fjalë.

¹² Referohuni arsyetimit në f. 18-19, të vendimit të Komisionit.

- Mbetet i pavërtetuar burimi i ligjshëm i dhurimit prej 5.000 euro nga babai i subjektit, ***, ***. Duket se personi tjetër i lidhur, babai i subjektit, nuk ka pasur mundësi për krijimin e shumës së dhuruar prej 5.000 euro.

16.3.1 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Në lidhje me burimin e vlerës prej 5.000 euro po paraqes gjetjet e audituesit ***, ***, lidhur me veprimet e kryera nga babai dhe shoqëria “****” si huadhënëse. Shuma prej 5.000 euro është tërhequr nga llogaria e shoqërisë “****” dhe është regjistruar në dokumentin kontabël ‘ditari i bankës’”.*

16.3.2 Komisioni, për sa më sipër, ka vlerësuar se: [...] *Kontabilizimi nga shoqëria “****” sh.p.k., i veprimit të dhënies hua ndaj ortakut ***, ***, përbën një pasqyrim të saktë të realitetit dhe situatës financiare. Për pasojë, ky veprim nuk ka sjellë dhe nuk mund të sjellë në të ardhmen shmangie të detyrimeve tatimore.Për qëllime të procesit të rivlerësimit, si të ardhura të ligjshme duhen konsideruar vetëm të ardhurat, të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative dy kritere: (i) janë të deklaruara; dhe (ii) për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi. Marrja e huas nga shoqëria “****” sh.p.k. për dhurimin në shumën 5.000 euro dhe reflektimi i kësaj huaje në librat e shoqërisë dhe pastaj në pasqyrat financiare nuk ka sjellë shmangie të detyrimeve tatimore, pavarësisht së veprimi i përfitimit të shumës prej 6.000 euro nuk është bërë duke shpërndarë fitimin (dividendin) në fund të vitit përkatës. Komisioni konstaton se ky veprim është përfshirë në dokumentet kontabël të shoqërisë si hua e dhënë, që do të thotë se është kontabilizuar si vlerë brenda bilancit të shoqërisë për të cilën në të ardhmen do të paguhen detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit (në kohën kur do të shpërndahet fitimi i shoqërisë). ... Në përfundim, duke marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit, shumën e përfituar si dhurim, burimin e dhurimit, veprimet e kryera dhe të reflektuara nga shoqëria “****” sh.p.k. në librat përkatës, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me dhurimin e shumës prej 5.000 euro (e cila ka shërbyer për blerjen e pasurisë automjet), pasi u provua burimi i ligjshëm i krijimit [...] ¹³.*

16.4 Për dhurimet në favor të subjektit të rivlerësimit:

- Shpjegimet e dhëna dhe pasqyrat financiare të shoqërisë “****”, të sjella si provë nga subjekti, nuk sqarojnë në mënyrë shteruese kërkesën e Komisionit. Vlerat e dhëna në bilancet vjetore janë vlera në fund të vitit, të cilat nuk sqarojnë veprimet e bëra gjatë vitit. Subjekti duhej të kishte sjellë të dhëna/regjistrime më analitike për të vërtetuar veprimet e kryera nga shoqëria lidhur me pasqyrimin e veprimeve në fjalë;
- Subjekti nuk e ka deklaruar saktë vlerat e dhurimit në DPV për vitin 2014;
- Ngelet e paprovuar mundësia financiare e babait të subjektit lidhur me shumën e dhuruara.

16.4.1 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Në vitin 2014, shuma e dhuruar nga babai është në vlerën totale prej 200.000 lekësh. Veprimet e dhurimit janë bërë nëpërmjet sistemit bankar (llogaria e babait në *** Bank). Burimi kanë qenë të ardhurat e babait nga aktiviteti tregtar si ortak i vetëm i shoqërisë “****” sh.p.k.”.*

¹³ Referohuni arsyetimit të Komisionit, në f. 15-16 të vendimit.

16.4.2 Komisioni, për sa më sipër, pasi ka kryer analizën financiare të personave të tjerë të lidhur, babait dhe nënës së subjektit të rivlerësimit, ka vlerësuar se: [...] *subjekti ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” dhurimet e dhëna nga babai në vlerën prej 200.000 lekësh, në vitin 2014, dhe u provua mundësia financiare për këtë dhurim nga personi tjetër i lidhur [...].*

16.5 Për konfliktin e interesit:

16.5.1 Komisioni, në analizë të dispozitave të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” të ndryshuar, posaçërisht nenin 21/1 dhe 24/1 të tij, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi ka vlerësuar se *subjekti i rivlerësimit ishte në shkelje të ligjit nr. 9367/2005, të ndryshuar, dhe se personi i lidhur (në kuptim të këtij ligji, i ati i subjektit) ka qenë dhe ka ushtruar veprimtarinë si ortak i vetëm i shoqërisë “***” sh.p.k., në kushtet e konfliktit të interesit, duke përfituar fonde publike të buxhetit të shtetit.*

16.5.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Për herë të parë jam njoftuar nga ILDKPKI-ja në datën 20.5.2021 dhe më 27.5.2021 jam vënë në dijeni për herë të parë lidhur me rrethanën e konfliktit të interesit. Menjëherë kam kontaktuar me babanë tim, pasi është një rrethanë që lidhet me të dhe babai im pas rreth 25 vitesh i ka dhuruar kuotat tek ***, ***, i cili nuk është person i lidhur me mua. Kam marrë të gjitha masat për të zgjidhur këtë situatë të ndaluar sipas ligjit, por unë personalisht nuk kam qenë në situatën e konfliktit të interesit. Për të përcaktuar nëse ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit duhet t’i referohemi ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005. Nuk kam zhvilluar asnjë gjykim me institucione me të cilat babai im ka lidhur kontrata publike, e cila mund të krijonte konfliktin në dukje të interesit...”*

16.5.3 Komisioni, për sa më sipër, ka vlerësuar se: [...] *qenia e babait të subjektit në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimit të pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, si dhe ligjit nr. 44, datë 24.4.2014, nuk mund të kualifikojë subjektin e rivlerësimit në kushtet e pamjaftueshmërisë në deklarin e kriterit pasuror, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, dhe të përbjë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit nga detyra [...].*

17. Komisioni, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, për kriterin e pasurisë, përfundimisht, ka vlerësuar se subjekti ka kryer deklarin të saktë të pasurive dhe interesave private, si edhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj në pronësi dhe përdorim.

18. Komisioneri Publik, në analizë të provave të administruara, mbështetur dhe në rekomandimin e ONM-së për paraqitje ankimi, vlerëson se përfundimi i arritur nga Komisioni nuk mund të konfirmohet si i drejtë dhe i bazuar. Nisur nga përmbajtja e arsytimit të këtij vendimi, në raport me provat e administruara dhe kuadrin ligjor të zbatueshëm, Komisioneri Publik çmon se, për rastin objekt ankimi, ngrihen disa çështje për zgjidhje dhe orientim, të cilat mund të kenë rëndësi dhe për njësimin dhe vlerësimin e rasteve të ngjashme, e për këtë arsye, e vlerëson të nevojshme që shqyrtimi dhe zgjidhja e këtij rasti të kryhet nga Kolegji si organi i vetëm gjyqësor, që vendos për vlerësimin përfundimtar në këtë proces.

19. Shqyrtimi i këtij rasti shihet i nevojshëm si në planin e vlerësimit tërësor të çështjes, duke rivlerësuar faktet e nevojshme, ashtu dhe me interpretimin dhe zbatimin e drejtë të ligjit dhe parimeve përkatëse, që udhëheqin procesin e rivlerësimit kalimtar.

20. Komisioneri Publik, duke pasur në vëmendje mangësitë dhe natyrën specifike që paraqet rasti, lidhur me interesat private të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, bazuar dhe në rekomandimin e ONM-së¹⁴, ku konstatohet se:

- (i) Për apartamentin e banimit në Vlorë, blerë në 2015 nga personi tjetër i lidhur, i ati i subjektit të rivlerësimit, të cilin ky i fundit e ka në përdorim pa kundërshtim, konfirmohet mundësia financiare e personit tjetër të lidhur për të blerë këtë pasuri, por jo ligjshmëria e burimeve të përdorura;
- (ii) Për apartamentin e banimit në Tiranë, blerë në 2014 nga personi tjetër i lidhur, i ati i subjektit të rivlerësimit, të cilin ky i fundit e ka pasur në përdorim gjatë periudhës 2014-2015, e drejtë reale kjo e padekluar, konfirmohet mundësia financiare e personit tjetër të lidhur për të blerë këtë pasuri, por jo ligjshmëria e burimeve të përdorura;
- (iii) Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me burimet e financimit për dhuratat në vlerën 200.000 lekë dhe 5.000 euro (të përdorura për blerjen e automjetit “Mercedes Benz B Class” në 2014), konfirmon mundësinë financiare për të dhuruar këto shuma nga ana e personit tjetër të lidhur, të atit të subjektit, por jo ligjshmërinë e burimeve të përdorura;
- (iv) Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti shpjegime dhe prova (kontrata me autoritetet publike) lidhur me konfliktin e interesit, të cilat mund të ndihmonin në përcaktimin e origjinës dhe fushëveprimit të këtij konflikti të pretenduar. Subjekti i rivlerësimit pretendon mungesën e dënjës së tij, e megjithatë, në të njëjtën kohë, deklaroi se në çdo rast, gjatë ushtrimit të detyrës, ka shmangur konfliktin e interesit;

çmon të paraqesë si çështje për shqyrtim dhe kontroll, nëse situatat faktike si më sipër, për qëllim të procesit të rivlerësimit, nenit 179/b, pika 1, të Kushtetutës, lidhur me kërkesat e nenit D/3 të aneksit të Kushtetutës, përlligjin përfundimet e arritura nga Komisioni për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit. Referuar praktikës së deritanishme të Kolegjit, është konsoliduar qëndrimi se *në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, konsiderohen si pasuri të ligjshme të ardhurat që janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit apo personi tjetër i lidhur në këtë rast dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi.*

20.1 Komisioni, në vlerësimin e pasurive në përdorim dhe posedim të subjektit të rivlerësimit, me burim të deklaruar nga të ardhurat e personit tjetër të lidhur me të, është mjaftuar në verifikimin e kapacitetit financiar të këtij të fundit (personit tjetër të lidhur), duke arsyetuar se në rastin konkret nuk rezulton shmangie nga detyrimet tatimore, pavarësisht se veprimet e përfitimit të shumave të përdorura për blerjen e këtyre pasurive nuk janë bërë duke shpërndarë fitim (dividend) në fund të vitit përkatës, duke ngelur kështu të paprovuara plotësisht kërkesat kumulative të nenit D/3 të aneksit të Kushtetutës. Nisur nga kjo, Komisioni vlerëson të mbështesë arsyetimin e tij në parimin e proporcionalitetit, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë.

21. Për sa i përket gjendjes së konfliktit të interesit, në vështrim të detyrimeve ligjore të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e

¹⁴ Referohuni pikës 5 të Rekomandimit të ONM-së, datë 17.9.2021.

funksioneve publike” të ndryshuar, duket se vlerësimi dhe arsyetimi i Komisionit nuk është i plotë, pasi ai ndalet vetëm në vlerësimin e kësaj gjendje të konstatuar në raport me kriterin e pasurisë, duke mos e bërë pjesë të një vlerësimi tërësor të çështjes apo dhe në këndvështrim të kontrollit të kriterit të aftësive profesionale. Komisioneri Publik vlerëson se gjendja e konfliktit të interesit, referuar rrethanave dhe natyrës së rastit konkret, në kontekstin e procesit të rivlerësimit, nuk duhet vlerësuar vetëm në raport me lidhjen e saj me interesat private, pasurinë në përdorim të subjektit të rivlerësimit, raport nga i cili Komisioni ka vlerësuar se nuk vërtetohet asnjë rrethanë që të lidhet me mosjustifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të tyre.

22. Në këtë drejtim, Komisioneri Publik konsideron se vlerësimi i rastit në raport me dispozitat e ligjit nr. 9367/2005, të cilat përcaktojnë institutin e interesit pasuror dhe gjendjen e konfliktit të interesit, si edhe kushtet dhe procedurat si një zyrtar duhet ta deklarojë dhe shmangë atë, më së paku duhet të detyronte subjektin e rivlerësimit, për shkak të parashikimeve ligjore, të ndërmerre masa për të shmangur gjendjen apo situatën e konfliktit të interesit ndër vite, fakt i cili nuk mund të justifikohet, nisur dhe nga formimi si magjistrat, me arsyen e mosdijënisë së subjektit. Në këto kushte, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit kishte përgjegjësinë dhe detyrimin të tregonte kujdesin e duhur për trajtimin dhe zgjidhjen e të gjitha situatave të mundshme të konfliktit të interesit apo atij në dukje, situatë kjo e cila mund të çojë në vlerësim negativ, referuar indikatorëve vlerësues sipas ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.

23. Duke përfunduar për sa më sipër analizuar, në vështrim të Komisionerit Publik, mbetet e paqartë nëse parimi i proporcionalitetit, i zbatuar nga Komisioni në këtë vendim është në përputhje me standardet e përdorura nga Kolegji në vendimet e mëparshme lidhur me parimin e proporcionalitetit, shkak për të cilin i paraqesim këtë ankim juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit, për vlerësimin dhe orientimin përkatës, referuar nenit 66/2, të ligjit nr. 84/2016, nën dritën e standardeve ekzistuese dhe gjetjet konkrete të kësaj çështjeje.

V. Kërkimi i ankimit

24. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

25. Duke nënvizuar se Komisioneri Publik, bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “C”, të aneksit të Kushtetutës, është institucioni i rivlerësimit, të cilit Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit i drejton rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim ndaj vendimeve të Komisionit;

26. Mbështetur në parashikimin e nenit F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkohet që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në përfundim të gjyqimit të çështjes, të vendosë në mënyrë alternative:


- Lënien në fuqi të vendimit nr. 410, datë 30.6.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ose
- Ndryshimin e këtij vendimi.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA

I bashkëlidhet këtij ankimi:

- Rekomandimi për ushtrim ankimi i një Komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të ONM-së, nr. 605/1 prot., datë 17.9.2021.



International Monitoring Operation
*Project for the Support to the Process of Temporary
Re-evaluation of Judges and Prosecutors in Albania*

Prot. No. 605/1

Tirana, 17/09 /2021

To the
Public Commissioners ✓

Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Nr. 6
Tirana
Albania



Case Number
Assessee

DC/VLO/1/05
Atalanta Zeqiraj

RECOMMENDATION TO FILE AN APPEAL

according to

Constitution of the Republic of Albania, Annex 'Transitional Qualification Assessment', Article
B, paragraph 3, littera c

Introduction

The assessee Atalanta Zeqiraj, judge of Vlora District Court, is one of the candidates to the Special Court for Corruption and Organised Crime, and therefore falls under the category of priority cases. She is assessed ex officio pursuant to Article 179/b, paragraph 3 of the Constitution of the Republic of Albania.

The Re-evaluation process was concluded based on three criteria: asset, background and proficiency. Upon administering the reports of the auxiliary bodies, thorough investigation of the case, administering evidence obtained through the investigation process and submitted by the assessee, the Independent Qualification Commission (hereafter: IQC) Adjudication Panel, finally closed the investigation on 14th June 2021, notified the assessee the findings, and the assessee remained with the burden to provide evidence or arguments against the preliminary conclusions based on the assets assessments. Following her submissions to rebut the established presumption, the panel decided to summon the assessee to the hearing.

The hearing took place on the 28th of June 2021 and following the deliberation as per Article 55 paragraph 5) Vetting Law, the Adjudication Panel decided to confirm the assessee in duty pursuant to Article 59 Vetting Law, and the decision was announced publicly on the 30th of June 2021.

Summary of recommendation

The International Observers recommend to the Public Commissioners to file an appeal against the decision of the Independent Qualification Commission of the 30th of June 2021 in the case of the assessee Atalanta ZEQIRAJ, case number DC/VLO/1/05, by which this assessee has been confirmed in duty.

The International observers with this recommendation seek for Appeal Chamber to assess if the standards and reasoning applied by the IQC to define proportionality in this case, are consistent with the standard of proportionality and reasoning used by the Appeal Chamber in the re-evaluation of comparable cases.

Basis of Recommendation

1. Under paragraph 3 of Article D of the Annex to the Constitution of the Republic of Albania” *The assessee has to credibly explain the lawful origin of assets, property and income. Income shall only be considered legitimate if it has been declared and taxes have been paid.*”
Whereas, under paragraph 5 of the same article”... *If the assessee takes steps to inaccurately disclose or hide assets in his or her ownership, possession or use, a presumption for the disciplinary measure of dismissal shall be established which the assessee shall have the burden to dispel.*”

Furthermore, under article 52 paragraph 2 Vetting Law, “ *If the Commission or the Appeal Chamber concludes that the evidence has reached the standard of proof under Article 45 of this Law for its report, the assessee shall have the burden to provide evidence or arguments about evidence against that conclusion.*”

Finally, pursuant to article 66 para 2, *The Appeal Chamber, in the reasoning of its decision, may give indication to the commission helping it to decide in similar cases.*

2. Through the Adjudication Panel’s decisions closing the investigation, which revealed: inaccuracy of disclosure, the failure of the assessee to provide sufficient evidence supporting the legitimacy of the sources of financing of her related persons for those assets the assessee received as gifts or otherwise has in use, and to clarify the conflict of interest deriving from the related person benefiting from public funds from the State budget; the burden of proof, as per article 52 paragraph 2 Vetting Law, was shifted to the assessee in the asset pillar, as described in the notification sent to her.
3. By the evidence and arguments provided after being notified about the result of the investigations, and the consequent inversion of the burden of proof, the assessee submitted with the reply: her interpretation on some legal standards, her interpretation of the facts, and claimed lack of knowledge about the existence of the conflict of interest, while however stating she never issued any decision involving Public Institutions as party in the proceedings. The panel invited the assessee to the hearing when the same arguments previously presented were exposed and further explained.
4. The adjudication panel after evaluating all circumstances and evaluating the assessee’s explanation in rebuttal to the preliminary conclusions on asset, concluded the assessee has not provided sufficient explanations to rebut all preliminary conclusions on asset. The same panel however concluded that, notwithstanding the issues contested and not explained, the identified shortcomings do not impede the confirmation of the assessee in duty, as in this case, the dismissal of the assessee, would not be proportioned and in line with the aim of the process of re-evaluation, because of reasons further elaborated in the decision.
5. Given the foregoing, the international observers make the following remark:
 - a. The legal standard used to qualify the assessee father as other related person is in line with the law and the existing jurisprudence, and pursuant to Article 32 para 4, assessee was rightly asked to prove the legitimacy of the sources of her other related person to finance the assets assessee received as gift or in use and explain her declarative shortcomings.

- b. The assessee's explanation about the sources used by her related person to acquire in 2015 the apartment in Vlora, in "Rruga *** **", in which she resides without compensation and of which she has exclusive use, confirms the theoretical financial capacity of her other related person to acquire the asset, but not the legitimacy of the sources used.
 - c. The assessee's explanation about the sources used by her related person to acquire in 2014 the apartment in Tirana, in "Rruga *** **", in which she resided without compensation in 2014-2015 while discharging her duties in Tirana District Court, and whose use she failed to declare, confirms the theoretical financial capacity of her other related person to acquire the asset, but not the legitimacy of the sources used.
 - d. The assessee's explanation about the sources of financing of her other related person to provide in 2014: the -not declared- gifts of 200.000 ALL, and the -not explicitly declared- gift of 5000 Euro used to purchase of the Mercedes Benz B Class-, confirms the theoretical financial capacity for the donation, but not the legitimacy of the sources used.
 - e. The assessee did not provide any explanation about the alleged conflict of interest, declaring her lack of knowledge and failing to submit any evidence, while she limited her explanation to confirm that in the discharge of her duties, she always respected the reasons foreseen in the law for abstention. Her reply, while mixing two different legal institutes, fails also to clarify how could the assessee safeguard the application of procedural rules for abstention, while claiming ignorance about the existence of her father contractual relationship with public institutions and the identity of the public representatives of such institution.
 - f. Finally, as transversal issue, the assessee's failure to provide to the Commission copy of her father's contracts with Public Institutions -which could assist in defining origin and scope of the alleged conflict of interest-, practically made impossible to distinguish in the re-evaluation of assets incomes acquired by her other related person in conflict of interest and used as sources of financing for the asset hereby described, from any other income acquired by the same in the discharge of his entrepreneurial activity.
 - g. It is worth mentioning nonetheless, assessee submitted the conflict of interest as alleged, was finally solved in May 2021, when the father ownership over the company, was transferred to the assessee's brother.
6. Finally, the undersigned observers note that, while entirely in the domain of the IQC to assess each case as individual without prejudice to the assessee, it remains unclear if the standard of proportionality applied by the IQC in this decision confirming Atalanta Zeqiraj, is consistent with the standards of proportionality used by the AC in previous decisions, and because of the

foregoing we remit this case to the AC for its determination about the specific nature of this case and its decision in light of the existing standards, and the concrete findings of this case.

7. Because of the foregoing, the IMO recommends an appeal against the IQC Decision of the 30th of June 2021.



International Observer

International Observer

International Observer